

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme nga neni 331 par.1 të KPK, sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.3344/2014 të datës 13.03.2015 pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 15.12.2015 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. M. nga i ati R. dhe e ëma Z. e lindur G., i lindur me datë “data e lindjes..” në Prizren ku edhe tani jeton rruga “.....” nr. ... , pa shkollë, nuk dinë shkrim lexim, punëtor krahu, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

PËR SHKAK

Se me datë 19.12.2014 rreth orës 21:30 minuta, në Prizren në restorantin “...” në mënyrë të kundërligjshme merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër që ta mbaj në posedim, pa qëllim të përvetësimit dhe atë telefonin celular të llojit “Samsung AC – 3” pronë e dëmtuarit M. A., në atë mënyrë që i dëmtuari derisa ishte duke pirë kafe në restorant, i akuzuari ka kërkuar telefonin që të kryej një shërbim dhe ishte larguar në drejtim të panjohur dhe kishte kërkuar të holla në vlerë prej 50 €, në mënyrë që t’ia kthej telefonin dhe një gjë të tillë kishte bërë pasi që kishte marrë të hollat.

Këso dore ka kryer veprën penale marrja në posedim pasurisë së luajtshme nga neni 331 par.1 të KPK.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73 dhe nenit 331 par.1 të KPK i shqipton:

VËREJTJE GJYQSORE

I akuzuari D. M. pasi që ka kryer veprën penale marrja në posedim pasurisë së luajtshme nga neni 331 par.1 të KPK, vepër penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, i njëjti nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohen me dënim më të rëndë.

I dëmtuari M. (R.) A. nga fshati Komuna e Dragashit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.3344/2014 të datës 13.03.2015, ushtruar kundër të akzuarit D. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale marrja në posedim pasurisë së luajtshme nga neni 331 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 19.12.2014 rreth orës 21:30 minuta, në Prizren i akuzuari D.M. me qëllim të përvetësimit të kundërligjshme për vete merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit që ta mbaj në posedim pa qëllim të përvetësimit dhe atë telefonin celular të llojit “Samsung AC – 3” pronë e dëmtuarit M. A. . I dëmtuari derisa ishte duke pirë kafe në restorantin “...”, i akuzuari kërkon telefonin e tij celular që të kryej një shërbim dhe pastaj largohet në drejtim të panjohur, i cili kërkon të holla në vlerë prej 50 €, në mënyrë që t’ia kthej telefonin i cili kishte arritur qëllimin një gjë të tillë ka bërë pasi që e merr të hollat nga i dëmtuari.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës me ç’rast është konstatuar se nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka pranuar fajësinë i cili ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç’rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer veprë penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi

vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi konform nenit 498 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.470/2015 të datës 15.12.2015

Procesmbjatesja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.